



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Qytetërimi i Amerikës Latine (I)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri: Viti II, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Spanjolle dhe Qytetërim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon t'i japë studentit një edukim të përgjithshëm rreth kulturave dhe qytetërimeve parakolombiane në Amerikën e Jugut dhe Qendrore, motivet që çuan në zbulimin e Amerikës, rolin e Kristofor Kolombit, si u krye procesi i Konkuistës, ndarja administrative, përzierja e popullsisë dhe krijimi i administratës koloniale. Revolucionet për pavarësi të vendeve të Amerikës Latine në fillim të shekullit të 19-të, figurat kryesore politike që i udhëhoqën këto lëvizje do të jenë gjithashtu objektivi i këtij kursi.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të analizojë në mënyrë kritike proceset historike që kanë ndodhur në Amerikën Latine gjatë periudhës prekolombiane, historisë Moderne dhe Bashkëkohore.
2. Të identifikojë ndryshimet kulturore, ekonomike dhe sociale në historinë e vendeve spanjishtfolëse të kontinentit amerikan
3. Të zhvillojë aftësitë gjuhësore: aftësia për të komunikuar me gojë dhe me shkrim
4. Të zhvillojë aftësitë dixhitale për të kërkuar dhe administruar informacionin në internet si dhe për të bërë komente e për të prezantuar projekte
5. Të zhvillojë aftësitë shoqërore dhe qytetare: nxitja e punës në grup dhe sensibilizimi për temat sociale.

Rezultatet të pritshme:

Studenti duhet të jetë i aftë të njohë proceset historike, të bëjë lidhjen midis faktorëve politike, ekonomike, sociale dhe kulturore si dhe të vlerësojë rolin e luajtur nga individë të veçantë në histori. Ai gjithashtu duhet të arrijë të analizojë dhe formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv për dukuri të ndryshme historike. Studenti duhet të njihet me terminologjinë historike dhe të jetë në gjendje të analizojë tekste në gjuhën spanjolle.